



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUKËS
DREJTORIA FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr. 4570 Prot.

Kukës më, 15.10.2024

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

Tema e konsultimit: “Për hartimin e draftit final të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”

Propozuesi i konsultimit: Kryetari i Bashkisë / Koordinatori GMS-së / Sekretariati i Këshillit të Bashkisë /Drejtori i Financës dhe Buxhetit.

Informacion për konsultimin: Në fazën përfundimtare të përgatitjes për hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027, Bashkia Kukës fton të gjithë të interesuarit që janë banorë të Bashkisë dhe Njësive Administrative, të bëhen pjesë e diskutimit publik rreth hartimit të PBA-së 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025 të Bashkisë Kukës, duke u angazhuar në përgjigjet e pyetjeve si më poshtë:

- A jeni ju të informuar mbi buxhetin e Bashkisë Kukës, shërbimet që kryhen me ndihmën e këtij buxheti dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve të Bashkisë Kukës?
- A jeni ju në dijeni se ka matës për treguesit e performancës së shërbimeve që ofron bashkia për komunitetin tuaj?
- A jeni ju në dijeni për procesin e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe buxhetit vjetor të Bashkisë Kukës, si një proces ligjor i domosdoshëm?
- A keni ju ndonjë opinion konkret në lidhje me mënyrën e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm nga Bashkia Kukës, hapat dhe fazat e këtij procesi?
- A keni ju një vlerësim për të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara gjatë vitit financiar 2024?
- A jeni ju në dijeni për Raportin vjetor të performancës të Bashkisë Kukës dhe për Raportin periodik të monitorimit të zbatimit të buxhetit?

- A keni ju ndonjë rekomandim konkret tuajin apo të komunitetit që përfaqësoni, për prioritetet e investimeve kapitale për vitet 2025-2027?
- A ndjeheni ju të përfshirë në procesin e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm dhe në procesin e monitorimit të buxhetit?
- A jeni ju në dijeni për faqen elektronike zyrtare të Bashkisë Kukës, publikimet e saj dhe a keni eksploruar apo marrë të dhëna në <https://kukesi.gov.al/>, a keni patur kontakte me specialistë të administrimit të web-it të Bashkisë Kukës?

Vendi, koha e konsultimit: Konsultimi do të organizohet ditën e Premte më datë 25.10.2024, ora 11⁰⁰ në sallën “Amerikan Corner” pranë Pallatit të Kulturës “Hasan Prishtina” Kukës.

Aktorët pjesëmarrës në konsultim:

Nga organizatorët: Kryetari, zv Kryetarët e Bashkisë, Kryetari i Këshillit Bashkiak, Drejtuesit e Ekipeve të Menaxhimit Programeve, Anëtarë të Këshillit Bashkiak, Drejtues të njësive Administrative.

Nga të ftuarit: Drejtues të institucioneve qendrore e rajonale, përfaqësues të shoqërisë civile , organizatave jofitimprurëse, medias dhe biznesit, banorë të Bashkisë.

Forma e konsultimit: Marrja e opinioneve dhe mendimeve nga të pranishmit në konsultimin publik, nëpërmjet diskutimeve, pyetjeve, propozimeve dhe rekomandimeve, paraqitja e konkluzioneve në mbledhjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik, në komisionet përkatëse dhe në Këshillin e Bashkisë Kukës.

Me respekt,

Kryetari i Këshillit Bashkiak Kukës

Albert MUJA

Kryetari i Bashkisë Kukës

Albert HALILAJ

